



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Tiranë, më 07.11.2023

Ditën e martë, në ambjentet e ERE, Kryetari i ERE z.Petrit Ahmeti si dhe Bordi i ERE, mirëpritën Kryetarin dhe Bordin e rregullatorit të Kosovës. Temat e diskutimit u fokusuan ndër të tjera në harmonizimin e bashkëveprimeve ndërmjet dy rregullatorëve për metodologjinë e tarifës së NEMO-s si dhe lidhur me çështje të tjera të cilat lidhen me bashkëpunimin e dy rregullatorëve.

Gjatë këtij takimi përfaqësuesit e të dy rregullatorëve patën gjithashtu diskutime mbi bashkërendimin e punëve lidhur me operimin e tregut të përbashkët të Ditës në



Avancë. Ky takim i Bordeve të të dy rregullatorëve, çon përpara procesin e bashkimit të tregjeve Shqipëri-Kosovë, duke vendosur fokusin në rëndësinë që ky bashkëpunim ka jo vetëm për tregjet përkatëse të energjisë elektrike por edhe për stabilitetin e sektorit në Rajon.